



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



**Drejtoria për Prokurim Publik**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: Grup i OE "Adnan Bislimi B.I.", me seli në Skenderaj, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën **06.10.2023**, merr këtë:

**V E N D I M**

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm, të subjektit në procedurë: OE "Adnan Bislimi B.I.", me seli në Skenderaj, në procedurën e prokurimit me titull: "Rikonstruimi i bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit sipas Lot I dhe II", Nr.Prokurimi: VU644-23-8965-5-1-1, Nr. i brendshëm: VU644-23-123-511.
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Njoftimi për Kontratë të dt. **14.09.2023**, i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë për Prokurim Publik.

**A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore të OE të lartpërmendur në Kërkesën për rishqyrtim, konstatoj se pretendimet e OE janë tërësisht të pabazuara, për faktin se Dosja e Tenderit është hartuar duke u bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik, përmes së cilës janë krijuar kushtet dhe mundësitë për pjesëmarrje (ofertim) të barabartë për të gjithë OE të interesuar.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Njoftimin për Kontratë e dt. 14.09.2023, ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 1, 7, 27, 28 dhe 69, si dhe nenet 17 dhe 25 të RRPP-së.

Ankuesi pretendon se:

1. Pretendimi i parë. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi që ka kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës min 1,000,000.00 euro. Kërkesa vlen për Lot I.
2. Pretendimi i dytë, Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim i ulët), në tri (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale për Lot I 3,400,000.00 €, dhe për Lot II 246,127.51 €. Në rastet e ofertimit si Grup i OE-ve, nga lideri i grupit kërkohet që ta përmbush minimumin 60% të vlerës së kërkuar.

**Këto dy pretendime janë plotësisht të pabazuara**, pasi që Autoriteti Kontraktues, me rastin e vendosjes së kërkesave të nenit 68 dhe 69 në FTD, për përqindjen e kërkuar nga lideri grupit, ka vepruar në harmoni me nenin 26.10 të Rregullores për Prokurim Publik, neni 26.10 citojmë: “Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së, ku AK mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësisht të kërkesave nga lideri i grupit të OE, si dhe në përputhje me Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, konkretisht sipas pikës (iii.) Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale. Shembull: Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000.00 euro dhe AK mund të përcaktoj në Njoftimin për kontratë se lideri i grupit preferohet të përmbush së paku 60%. Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesa për qarkullim duhet të shprehet detyrimisht në shifra dhe duhet t'i referohet maksimum tri viteve të fundit financiare. Vitet e tilla financiare duhet të përcaktohen qartë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje. Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës e Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, shembull: Kërkesa: OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjatë 3 viteve të fundit ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet e fundit financiare prej jo më pak se: 500,000.00 Euro. Dëshmi: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit financiare.

**Pretendimi i tretë, E)Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master i diplomuar-drejtimi hidro, me me se paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit te jete i certifikuar me VNM se paku 7 vite përvojë pune. - Vlen për Pjesën I dhe Pjesën II.**

**Ky pretendim është plotësisht i pabazuar**, pasi që ka të bëjë me infrastrukturë nëntokësore ekzistuese, e cila duhet të trajtohet nga një profesionit, i cili përveç zgjidhjes teknike të ketë parasysh ndikimin e shtrirjeve të rrjeteve nëntokësore, të cilat gjenden në afërsi të parkut të qytetit, i cili mund të shkakton ndonjë çrregullim të ujërave të zeza atmosferike, të cilat mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti në drunjtë e vjetër, të cilët janë në parkun e qytetit.

**Pretendimi i katërt, G)Një(1) Master i shkencave teknike drejtimi-Gjeoteknike.**

**Ky pretendim është plotësisht i pabazuar**, bazuar në atë që lokacioni i përfshirë për ndërtim ka të bëjë me rrjedhje natyrore nëntokësore të ujit, të cilat i furnizojnë burimet e ujit (qeshmë), prandaj konsiderojmë se një kuadër profesional i tillë është i nevojshëm për projektin.

**Pretendimi i pestë, H)Një (1)Master i shkencave teknike drejtimi- inxhinieri i mbrojtjes së mjedisit, dhe i certifikuar nga AME minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit - Vlen për Pjesën I.**

**Ky pretendim është plotësisht i pabazuar**, pasi që projekti në fjalë është në brendinë e qytetit, ku është i rrethuar me objekte të banimit të mëdha dhe të mesme, si dhe ekziston frekuentim, prandaj AK e ka vlerësuar të arsyeshëm këtë profesionit.

**Pretendimi i gjashtë, Stafi teknik – Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me staf Teknik dhe atë e)Një (1) Lllamarinë Punues; dhe f) Një elektroinstalues.**

**Ky pretendim është plotësisht i pabazuar**, pasi që stafi i cili është cekur në Dosjen e Tenderit, AK ka konsideruar se është i nevojshëm për projektin në fjalë, sepse kemi të bëjmë me punë të llamarinës dhe me instalues të rrjetit elektrik.


**Pretendimi i shtatë, Te Aneksi 7. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM:**  
Kamion kiper me kran, maximum 2 ton pesha bartese; Eskavator 38 ton, min; Traktor 4x4, pasha min 4000 kg; Luge ngarkuese 18 ton sasia dhe Damber 2 ton; Gjysem remorkio bujgesore; Frez hidraulike për gërryerjen e gurit; Mbrojtese kanali metalike min; Makin per shpime horizontale me sistem te kontrollit llaserik DN 110-550 mm; Gjenerator 45-75 kw; Kran statik me lartesi minimum 30 m dhe me krah minimum 45 m, dhe Nivelizues laser.

**Ky pretendim është plotësisht i pabazuar**, sepse mekanizmat e Aneksit nr.7 janë të nevojshme për projektin në fjalë, pasi që projekti ka të bëjë me infrastrukturë nëntokësore dhe mbitokësore ekzistuese, siç janë: pllaka e armuar, për të cilën duhet një pjesë e madhe të demolohet, materiali i demoluar duhet të ngarkohet dhe transportohet në deponi legale.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se pretendimet ankimore të Ankuesit janë plotësisht të paargumentuara, si dhe për rrjedhojë të pa bazuara, andaj A.K. konstaton se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshe nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik**  
**K.R. nr. 123/2023 - datë 29.09.2023**

**Drejtoria për Prokurim Publik**

  
**Alban Tahiraj - Drejtor**

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës,
2. 1 x DPP-së, dhe
3. 1 x Arkivit (1 kopje)